



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 30.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 07.04.2024, të parashtruar nga OE Argo Med SH.P.K., lidhur me **Lot 8**, të aktivitetit të prokurimit me titull: Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së" me nr. të Prok: 206-23-11488-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE Argo Med SH.P.K e dt. 07.04.2024 lidhur me **Lot 8** të aktivitetit të prokurimit: **Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së"** me nr. të Prok: 206-23-11488-1-1-1 kundër Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 02.04.2024;
2. **Anulohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 03.04.2024 - për Lot 8;
3. Autoriteti Kontraktues, e kthen në Ri-vlerësim aktivitetin e prokurimit - për Lot 8;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE Argo Med SH.P.K. me date 07.04.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me **Lot 8**, të aktivitetit të prokurimit me titull: **Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së"** me nr. të Prok: 206-23-11488-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 30.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

- AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së Nr. 04/L-042 dhe nenin 4 të RRPP-001/2022,
- AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042,
- AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së Nr. 04/L-042,
- AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së Nr. 04/L-042,
- AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së Nr. 04/L-042,
- AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042,
- AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së Nr. 04/L-042,

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kriterëve të parapara me Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Më saktësisht AK pa të drejtë ka shpërblyer me kontratë OE Medi Health L.L.C. i cili nuk e ka plotësuar specifikimin teknik të kërkuar nga AK. Bazuar në nenet e cekura më lartë si dhe bazuar në nenin 4.1.c të RRPP-001/2022 AK duhet të luaj rol aktiv në shpenzimin e parasë publike në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike përkatësisht duhet që detyrimisht të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Me vet faktin që AK po kontraktonte një OE i cili nuk e plotëson specifikimin teknik, tregon se AK po tenton të blejë një pajisje që nuk i posedon të gjitha funksionet e kërkuara andaj edhe vlera e kontratës del të jetë mashtruese dhe shumë e lartë për një pajisje të tillë e cila realisht duhet kushtoj për gjysmë më lirë. Mungesa e specifikimeve teknike të cilat do të i elaborojmë në pretendimet e radhës, e bënë jo funksionale pajisjen e tillë andaj del të jetë që shpenzimi i parasë publike po bëhet kot se koti dhe për një pajisje gjysmake me mungesë të disa funksioneve shumë të rëndësishme për të cilat edhe është kërkuar.

Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet lehtë se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së si dhe nenin 4 të RRPP-001/2022 gjatë vlerësimit të tenderëve duke mos vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht Aneksit 1 dhe duke mos administruar procedurën e prokurimit sipas neneve të cekura më lartë.

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve e ka favorizuar OE Medi Health L.L.C. të cilin edhe e ka shpallur fitues. Kjo ka ardhur si pasojë e asaj që AK e ka konsideruar të përgjegjshëm këtë OE edhe pse i njëjti ka mangësi në tenderin e tij që e bëjnë pajisjen e ofruar të papërdorshme për qëllimin ndërsa OE e bëjnë të papërgjegjshëm. E themi këtë sepse ky OE ka ofruar pajisje që nuk i plotëson specifikimet teknike ashtu siç janë kërkuar tek dosja e tenderit përkatësisht tek Aneksi 1 i sajë. Mos kontestimi i këtyre mangësive nga ana e AK-së e shtynë këtë të fundit drejt shkeljes së plotë të nenit 7 të LPP-së.

Sipas asaj që e thotë neni 7 i LPP-së, kjo konsiderohet trajtim jo i barabartë i tenderuesve përkatësisht favorizim i hapur i këtij OE e që njëherit konsiderohet shkelje e pastër e kësaj dispozite ligjore. Detalisht për secilin gabim të AK përkatësisht të komisionit të vlerësimit që kanë bërë gjatë këtij procesi të vlerësimit, do ju njohim në pretendimin në vazhdim.

3. AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së kur neve nuk na e ka dhënë mundësin e qasjen në dokumentet e tenderit edhe pse kemi dorëzuar kërkesë për qëllimin e tillë. E themi këtë sepse sipas nenit 10 të LPP-së thuhet qartë se me kërkesë të një OE të interesuar, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa gjë të cilën AK nuk na e ka mundësuar.

Tek nenin 11 i LPP-së shumë qartë thuhet se cilat kushte duhet të plotësohen për tu cilësuar një informatë e caktuar si konfidenciale, kushte të cilat nuk janë plotësuar nga kërkesa e OE Medi Health L.L.C.. Ja si duket kërkesa e tillë:

DUKE PASUR PARASYSH SE *Medi Health L.L.C.* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

6. *Autorizimet Bbraun Rontis*
7. Confirmation letter Spare Part Supply
8. Broshura dhe katalogjet e nënvizuara

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtrimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Per shkak te mundesise se keqperdorimit demi do te ishte financiar

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Për të qenë më korrekt po i paraqesim kushtet e tilla drejt për drejtë nga ligji:

Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste

3. Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:
 - 3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;
 - 3.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikulit e tillë si sekret; dhe
 - 3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtrimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Pra krahasuar kërkesën e këtij OE me paragrafin 3.3 të nenit 11, del që OE në fjalë nuk ka ofruar deklaratë apo ndonjë dëshmi me të cilën mund të vërtetohet se zbulimi i dokumenteve të tilla do i krijoj dëmtrim material të interesave të tijë.

Pika 11.3.1 dhe pika 11.3.3 nuk janë plotësuar nga kërkesa për sekret afarist e dërguar nga OE Medi Health L.L.C. dhe përpos kësaj, kërkesa përmban edhe dokumente që nuk bien tek nenin 68 dhe 69 i LPP-së, si dhe nuk është ofruar deklarata me shkrim me të dhënat e kërkuara tek pika 3.3 e nenit 11 të LPP-së. Vlen të ceket se sipas nenit 11.3.1 të LPP-së vetëm dokumentet e përcaktuara nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji mund të konsiderohen sekret afarist ndërsa AK pa asnjë bazë ligjore ka mbajtur si të tilla komplet dosjen e tenderit të këtij OE.

Pavarësisht nga kërkesa e OE që dokumentet e caktuara të mbeten sekret afarist, është AK ai i cili duhet të vendos në përputhje me nenin 11 të LPP-së se cilat nga dokumentet mund të pranohen si sekret afarist. AK nuk e ka bërë fare këtë analizë por pa asnjë të drejtë ligjore ia ka konsideruar si sekrete të gjitha dokumentet që ky OE i ka kërkuar të mbeten sekret afarist.

Se kur duhet të pranohet një kërkesë e OE për konfidencialitet lidhur me dokumentet e tenderit e sqaron edhe Interpretimi 31 i KRPP-së të cilin AK nuk e ka respektuar fare.

Për pasojë të kësaj ne nuk kemi mundur të informohemi me përgjegjshmërinë apo jo të këtij tenderuesi dhe për shkeljet e mundshme të shkaktuara nga AK mbi bazën e të cilave do të parashtronim kërkesë për rishqyrtim me pretendime të tilla andaj me të drejtë konstatojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 10 të LPP-së.

3. AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së pasi që fillimisht në kundërshtim me paragrafin 3 të këtij neni e ka pranuar kërkesën për konfidencialitet si të rregullt edhe pse ajo nuk i plotëson dy nga tre kushtet e këtij neni. Më pas në kundërshtim të plotë me paragrafin 3.1 të nenit 11 të LPP-së ka

mbajtur si sekret afarist dokumente që nuk bien në grupin e dokumenteve të kërkuara nga AK sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së.

AK ka vepruar në kundërshtim të plotë edhe me paragrafin 4 dhe 5 të nenit Neni 11 i LPP-së sepse nuk e ka përgatitur fare versionin e pastruar të dokumenteve të cilat më pas do duhej të na ofroheshin neve sipas kërkesës për qasje në dokumentet e tenderit. Paragrafi 4 i nenit 11 të LPP-së e detyron AK-në që të përgatitë versionin e pastruar të secilit dokument të tillë dhe të i jepet qasje OE-së që e kërkon qasjen në ato dokumente. Këtë nuk e ka bërë AK dhe shihet hapur që ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 11 të LPP-së.

Bazuar në krejt këtë po shihet hapur se AK nuk ka veruar aspak sipas ligjit kur neve na ka refuzuar qasjen në dokumentet e tenderit të OE që ishte shpallur fitues andaj si përgjegje ndaj kësaj po i drejtohem AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim. Në këtë kërkesë kemi dhënë mbështetjen e mjaftueshme ligjore mbi bazën e të cilës AK duhet që ta aprovoj si kërkesë të bazuar dhe të veproj në përputhje të plotë me ligjin dhe dispozitat që i përshkruajnë situatat e tilla. Nga krejt kjo dhe me arsye të plotë konstatojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 11 të LPP-së.

4. AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së – pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka respektuar kërkesat që vet i ka vendosur në dosje të tenderit përkatësisht në Aneksin 1 të dosjes. Ky veprim i AK-së bie në kundërshtim të plotë edhe me praktikatat e mira të prokurimit të përcaktuara tek neni 19 i RRPP-001/2022 i cili ndër të tjera thotë:

19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

OE i shpallur fitues nuk ka plotësuar karakteristikat teknike të kërkuara sipas Aneks 1 përkatësisht pasi që pajisja e ofruar nuk e plotëson kërkesën nga pika 1.4, 2.2 dhe 5.2 e Aneksit 1. Si pasojë e kësaj dhe për mangësi të tilla AK është dashur ta cilësoj të papërgjegjshëm e jo të anashkaloj kërkesat e veta dhe ta shpallë fitues. Nisur nga kjo konstatohet se AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së, Nenin 19 i RRPP-001/2022 si dhe nuk ka respektuar as kërkesat e parashtruara nga vetë AK-ja në dosjen e tenderit.

5. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit respektivisht nga Aneksi 1 i sajë ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në rastin konkret AK nuk e ka respektuar fare këtë dispozitë sepse e ka shpallur fitues OE Medi Health L.L.C. edhe pse i njëjti ka mangësi të theksuara tek specifikimet teknike të ofruara. OE Medi Health L.L.C. në Lot 8 ka ofertuar me artikullin OMNI B.BRAUN dhe këtë e kemi kuptuar vetëm nga Certifikata CE (*shiko certifikatën CE të bashkangjitur*) pasi që dokumentet tjera i ka kërkuar të jenë sekrete dhe nuk kemi pasur qasje. Vlen të thuhet se ky OE ka kërkuar që të mbahen sekret disa dokumente siç i cekëm tek pretendimi i shkeljes së nenit 10 dhe 11 të LPP-së për çka ne e kemi pasur shumë të vështirë të sigurohemi për plotësueshmërinë e specifikimeve teknike.

Gjatë hulumtimit në internet, tek faqja zyrtare e B.BRAUN kemi vërejtur se kur të krahasohet produkti i tij (*ai që OE e ka ofertuar*) me kërkesën e AK-së, del që kjo pajisje nuk i plotëson të gjitha specifikimet teknike të kërkuara. Çka është më e rënda, kjo pajisje nuk e kryen funksionin kryesor për çka ishte kërkuar. Pajisja e tillë OMNI nuk e posedon mundësin e kryerjes së funksionit të kërkuar tek pika 1.4, pra nuk mundet ta kryej trajtimin e gjendje septike të pacientëve. Kërkesa e AK-së tek FDT për CE certifikata apo Deklarate të konformitetit për artikujt e ofertuar ishte kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

9.1 & 9.2

Kërkesa 5. Kërkohe certifikata CE e produkteve. Pranohe të ofrohe CE Certifikata ose Deklarata e konformitetit.

Dëshmia 5. Kopje e certifikatës CE për produktet ose Deklarata e konformitetit.

Nga qasja që kemi pasur në dokumentet e tenderit të OE të shpallur fitues shihet se i njëjti ka dorëzuar vetëm një certifikatë CE nga B.BRAUN. Tek kjo certifikatë nuk është i përfshirë filtri për trajtimin e gjendjeve septike andaj nga tregohet qartë se ky OE nuk e ka plotësuar këtë kriter. Përpos kësaj ne e dimë që B.BRAUN nuk prodhon filtra për trajtimin e gjendjeve septike dhe kjo e bënë OE në fjalë komplet të papërgjegjshëm.

Lidhur me funksionet e pajisjes, AK kishte vendosur edhe një specifikim teknik tek Aneksi 1 të cilin ky OE nuk e ka plotësuar në tërësi. Ndër kërkesat tjera ishte përshkrua edhe kërkesa për funksionin e largimit të toksinave inflamatore endogjene.

Kërkesa ishte përshkruar në këtë formë:

1.4 With this device, the procedure for reducing the load of endogenous inflammatory toxins in the circulation (eg in septic conditions) is possible.

Po që se shikohet me vëmendje certifikata CE, shihet se askund nuk shkruan që B.BRAUN prodhon filtër për largimin e toksinave inflamatore endogjene i cili është i nevojshëm për trajtimin e gjendjeve septike, prandaj kjo pajisje nuk mundet ta kryej këtë funksion dhe si e tillë nuk e plotëson kërkesën e AK-së. Këtë konstatim e japim duke u mbështetur në faktin shkencor që trajtimi i **sepses** bëhet vetëm e filtrin adekuat për **sepsë**. Përpos kësaj edhe tek katalogu i shkarkuar në faqen zyrtare të B.BRAUN, tek faqja 1 aty ku përshkruhen funksionet e pajisjes, trajtimi i **sepses** nuk ekziston si mundësi. Pra kjo tregon se pajisja e tillë nuk e posedon këtë funksion që është kryesori i pajisjes dhe si e tillë është e papranueshme. Ju si AK, duhet ta kontrolloni edhe një here katalogun e pajisjeve dhe certifikimin e ofruar nga ky OE dhe do të bindeni me mangësinë e tillë.

Përpos kësaj nga certifikata CE dhe nga katalogu online, shihet se pajisja e tillë nuk e plotëson as kërkesën e Aneksit 1 - Lot 8 tek pika 2.2 rreshti 2. Kërkesa e tillë tek specifikimi teknik ishte përshkruar nga AK në këtë formë:

2.2 Should perform:

- Therapeutic Plasma Exchange (Therapeutic Plasma Exchange) TPE
- The possibility of treating septic conditions
- Option for CRRT, all modes
- CVVH (continuous venous hemofiltration)
- CVVHD (continuous venous hemodialysis)
- CVVHDF (continuous hemodiafiltration)
- SCUF (slow continuous ultrafiltration)

Pra me që tek certifikata CE dhe tek katalogu online shihet hapur se pajisja nuk ka certifikim CE për këtë funksion dhe përdorim, konstatojmë se nuk e plotëson këtë kërkesë të AK-së. Për më tepër, për realizimin e këtij funksioni nevojiten aksesorë specifik – Filtër Set të veçantë, të cilët duhet të jenë gjithashtu të certifikuar CE. Tek tenderi i këtij OE, përpos që nuk janë ofruar filtrat e tillë, nuk është ofruar as certifikata CE për filtrat, pa të cilët s'ka asnjë mundësi të kryhet ky funksion i trajtimit të **sepses** (septic conditions). Ofrimi i filtrave për trajtimin e gjendjeve septike ka qenë edhe kërkesë e veçantë e AK-së. AK ka kërkuar filtra për secilin funksion që duhet të

kryej pajisja me aksesorët përkatës ndërsa vetëm për trajtimin e sepses ka kërkuar 30 filtra. Ja dëshmia se AK i kërkon filtrat e tillë:

5 Accessories configuration System, spares and consumables

SI Name Technical Specifications quoted by Providers Deviation if any.

5.1 System as specified -

5.2 Thirty (30) disposable plasma exchange therapy kits and sets, thirty (30) for sepsis, and ten

(10) for each form of CRRT, must be provided and delivered with the equipment.

Kjo len të kuptohet se funksioni kryesor i pajisjes me aksesorët përkatës është trajtimi i sepses dhe me që B.BRAUN nuk prodhon fare filtra të tillë për këtë trajtim, tregon mjaftueshëm se pajisja e tillë nuk e plotëson kërkesën e AK-së lidhur me përshtatshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara. Për të treguar se pse kjo pajisje e ka çmimin shumë më të ulët se ajo që ne e kemi ofruar, po ju japim një informacion të rëndësishëm lidhur me koston e një filtri nga 30 sa janë kërkuar nga AK. Vetëm një filtër për trajtim të sepses e ka çmimin e përafërt (700-800)€. Kur kjo shumëzohet me sasinë e kërkuar, del që vetëm këta 30 filtra kapin vlerën (21.000.00-24.000.00)€. Shto këtë çmimit të ofruar nga OE i shpallur fitues dhe shih se ku do i del çmimi i tij.

Marrë parasysh faktin që pajisja e ofertuar nga Medi Health L.L.C. se pari nuk është e certifikuar me CE për funksionin e largimit të toksinave inflamatore endogjene që është e nevojshme për trajtimin e gjendjeve septike, dhe se dyti as nuk posedon filtrat e veçantë përkatës të nevojshëm për këtë funksion, tregon mjaftueshëm se pse kjo ofertë është e papërgjegjshme dhe në kundërshtim të plotë me kërkesat dhe specifikimet teknike të vendosura nga vetë AK. Mangësia serioze në material dhe mungesa e plotë e certifikimit CE tregon edhe arsyen pse ky çmim është më i ulët se çmimi jonë.

Pra pajisja me aksesorët përkatës nuk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe se OE në fjalë është dashur të shpallet i pa-përgjegjshëm. Për të vlerësuar saktë dhe drejtë pajisjen e tillë, AK duhet të kërkojë mbështetje profesionale nga Sektori i Nefrologjisë sepse ata janë njohësit më të mirë të këtyre pajisjeve. E themi këtë sepse ata janë vet njësia kërkuese dhe se merren çdo ditë me këtë punë.

Sipas krejt kësaj po shihet hapur se OE në fjalë është i papërgjegjshëm pasi që pajisja (me aksesorët përkatës) me të cilën ka ofertuar, nuk i plotëson specifikimet e kërkuara nga AK. Duhet cekur edhe kjo se përdorimi i kësaj pajisjeje në pacient, për trajtimin e gjendjeve septike në kushtet kur ajo nuk ka certifikim CE për këtë përdorim dhe me filtra të prodhuesve të tjerë gjithashtu certifikim CE, do të mbarte rrezikun që çdo vdekje eventuale të mund konsiderohet si rast mjeko-ligjor për shkak të përdorimit të një teknologjie që nuk posedon certifikim CE. Nisur nga sa u tha deri më tani, del që pranimi i këtij OE si tenderues i rregullt e shtynë AK-në drejt një vlerësimi joprofesional i cili është në kundërshtim të plotë me kërkesat e nenit 59 të LPP-së si dhe në kundërshtim edhe me kërkesat e vet AK-së të vendosura tek Aneksi 1 i dosjes së tenderit.

6. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me LPP-në dhe si pasojë e kësaj ka shpërblyer me kontratë një OE që të papërgjegjshëm. Edhe pse çmimi i tij është më i lirë në krahasim me neve, me që ky OE nuk është tenderues i përgjegjshëm, del që AK nuk ka vlerësuar fillimisht sipas nenit 56.1.1 të LPP-së e për pasojë del ta ketë shkelur edhe nenin 60 të LPP-së. . Kjo konsiderohet shkelje e plotë e të gjitha dispozitave që flasin për administrimin e drejtë të parasë publike si dhe konsiderohet shkelje e plotë edhe e kriterit të vlerësimit i vendosur në përputhje me nenin 60 të LPP-së që OE fillimisht duhet të vlerësohen për përgjegjshmërinë e mandej për çmimin. Ja si e përshkruan këtë detyrim të AK-së neni 56.1 i LPP-së:

Neni 56

Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

1. Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të lillë, dhe përmes:
 - 1.1. së pari, vlerësimi të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;
 - 1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Nisur nga gjendja faktike në tenderin e OE fitues dhe në tenderin tonë, si dhe nisur edhe nga krejt ato që thamë me lartë, kërkojmë nga AK që të marr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "ARGO MED SH.P.K." lidhur me tenderin "Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së" - Lot 8" i iniciuar nga **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **MINISTRIA E SHËNDETËSISË** për Lot 8 dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit e që realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallej OE "ARGO MED SH.P.K."

Dëmet materiale

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Pranohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për Rishqyrtim e dates 07.04.2024 nga OE Argo Med sh.p.k. për Lotin 8 të procedurës së prokurimit me titull Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për nevojat organizative të QKUK" me nr. të Prok: 206-23-11488-1-1-1.

Sqarime profesionale të dhëna nga profesionistët - bioinxhinierët e SHSKUK-së për Lot 8:

1. Pajisje për ndarje të qelizave të gjakut - Pajisja Aferezë, OE i rekomanduar ka ofertuar me Modelin: Bbraun OMNI® tipi ECC02R.

1.1 Në dokumentet e OE të rekomanduar, nuk mund të identifikohen disa specifikat teknike të listuara si më poshtë:

- a. With this device, the procedure for reducing the load of endogenous inflammatory toxins in the circulation (eg in septic conditions) is possible - Kjo specifikë teknike nuk gjendet në katalogët që OE e ka dorëzuar ne oferte.
- b. The possibility of treating septic conditions- Kjo specifikë teknike nuk gjendet në katalogët që OE e ka dorëzuar ne oferte.

OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka dëshmuar me dokumente edhe set-et si në vijim:

5.2 Thirty (30) disposable plasma exchange therapy kits and sets, thirty (30) for sepsis.

Ndërsa për set-et si më poshtë të kërkuara:

(10) For each form of CRRT, must be provided and delivered with the equipment.

OE ka ofertuar Set-in: omni-ecc02r i cili në bazë të dokumentacionit mund të përdoret për largimin e C02 dhe në të gjitha modet e CRRT por nuk ka informata që mund të përdoret për (Therapeutic Plasma Exchange) TPE dhe treating septic conditions.
Pra OE i rekomanduar e ka ofruar vetëm dokumentin për setin OIVINI@ ECC02R.
Mungojnë dokumentet për set-et e tjera.

Andaj kërkohet që OE të rekomanduar për kontratë të i kërkohet të i nënvizoj dhe të tregoj se në cilat dokumente dhe ne cilat pjesë të paraqitura në dosjen e dërguar janë këto informacione apo të dhëna të cilat janë kërkuar në Aneksin 1

2. Pajisje për ndarje të qelizave të gjakut - Pajisja Aferezë (Operatori Ekonomik ankues ka ofertu me pajisjen BAXTER PRISMA FLEX dhe si pajisje i ofron të gjitha specifikat e kërkuara nga DT mirpo mungojnë pikat e poshtë shënuara.

7.3 Suitable maintenance free battery UPS for minimum one-hour backup shall be supplied with the system.

7.4 List of equipment available to provide calibration and routine preventive maintenance support. according to the manufacturer's documentation in the service/technical manual.

Per piken 5.2 per 30 sete, OE te rekomanduar i kemi kërkuar sqarime shtese dhe me dt. 18.04.2024 e ka ofruar deklaratën e cila mbante datën 23.02.2024 dhe me përmbajtjen si me poshtë:

MEDI HEALTH

Adresa: Magjistratja Eerizaj-Prishtine, Llapnaselle, Gracanice.

E-mail: medihealthllc1@gmail.com

Mob: 044/900-523

Data: 23.02.2024

Deklarate

Deklarojme se se bashku me aparatoren ashtu si eshte kerkuar ne Specifikimin Teknik ne piken 5 si me poshte:

5.2. Ofrojme 30 Kite dhe Sete per "Plasma exchange therapy", 30 Sete per trajtimin e Sepsës dhe 10 Sete per secilen metode te CRRT.

5.3. I gjithë materiali i nevojshem i cekur me larte ofrohet gratis ashtu si eshte kerkuar.

5.4. Ju sigurojme se do te kete furnizim te rregullt per 5 vitet e ardhshme me Sete(Kite) per te gjitha procedurat me emime te rajonit.



Por nuk qëndron deklarimi i OE te rekomanduar se: *"deklaraten e njejt e kemi dorezuar edhe me oferten tone"* meqenëse ne oferte eshte deklarata e datës 23.02.2024 me kete përmbajtje:

MEDI HEALTH

Medi Health LLC
Adresa: Prishtine-Ferziaj, 10.000 Prishtine, Kosove.
Mob: +383/44/900-523
Email: medihealth1@gmail.com

Për: Ministria e Shendetesise
Prishtine
Kosovë

Data: 23.02.2024

DEKLARATË

Deklarojmë se oferta jonë është në përputhje me specifikat teknike te kërkuara në Dosjën e Tenderit për aktivitetin e prokurimit me numër prokurimi: 206-23-11488-1-1-1.

Eltion Krasnigj



Duke marre parasysh se OE i rekomanduar, sipas profesionisteve - bioinxhinierëve nuk e ka plotësuar specifikën e kërkuar **per trajtimin e sepses**, qe eshte edhe pretendimi ankimor kryesor, ZPP konsideron se ky aktivitet per Lot 8 duhet te kthehet ne Ri-vleresim dhe te rishikohen edhe një here ofertat e pranuar per kete aktivitet - Lot 8.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit